



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:226892

Datë: 03.09.2024

Numri i dokumentit: 06196699

KA.nr. 698/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “HIB Petrol” ShPK me NUI 810662834 me seli në magjistralen Ferizaj-Prishtinë në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresë në rrugën “Robert Doll”, nr.19, Prishtinë, kundër të paditurës Inspektorati i Tregut Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 19.08.2024, në të cilin mori pjesë përfaqësuesi i paditësit ndërsa i padituri mungoi, më 3 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e “HIB Petrol” ShPK me NUI 810662834 kundër të paditurit Inspektorati i Tregut Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 6420 të datës 06.09.2021 të lëshuar nga i padituri dhe kthimin e çështjes në rishqyrtim.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 11.10.2021 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 6420 të datës 06.09.2021 të lëshuar nga i Padituri dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
2. Ai në padi ka pretenduar se i Padituri më 05.07.2021 e ka inspektuar njësinë e tij në rrugën “Gasper Karaqi” në Gjakovë, ku gjatë inspektimit përmes procesverbalit me nr.19/000519 ishte konstatuar se ai nuk posedon dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët e tregut, konkretisht licencën për shitjen me pakicë të GLN-së dhe faturën e furnizimit me GLN, rrjedhimisht atë e ka gjobitur me 1,000.00 euro. Sipas tij, ai ka

parashtruar ankesë kundër aktvendimit, ndërsa atë e ka refuzuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut si organ i shkallës së dytë.

3. Paditësi gjithashtu ka theksuar se në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar janë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore për faktin se, i Padituri vendimin e ka bazuar në dispozitën e nenit 14 par.14 .1 14.2 dhe 14.3 të Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut që sanksionohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-186 për plotësimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, ndërsa sipas kësaj dispozite ligjore i Padituri me rastin e nxjerrjes së Procesverbalit nr. 10/000519 nuk ka dhënë kohë të mjaftueshme për të siguruar faturën për furnizim ne GLN, të cilën Paditësi e ka në posedim, por për shkaqe të brendshëm nuk ka mundur t'ia prezantoj në kohën caktuar Inspektoratit. Ndërsa sa i përket licencës për shitje me pakicë në GLN nuk është kontestuar faktin se në momentin e inspektimit nuk ka poseduar licencë, por më datë 10.08.2021 në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka parashtruar kërkesën për licencim.
4. Si përfundim ka deklaruar se vendimi i kundërshtuar me padi i nxjerr nga ana e të paditurës është i përfshirë në shkëlje esenciale si pasojë e arsyetimit të mangët që konsiston në shkeljen e nenit 48 të Ligjit Nr. .05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
5. I padituri në përgjigjen në padi ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e Paditësit, duke theksuar se personi përgjegjës i Paditësit nuk ka sjell dokumentet e kërkuara nga inspektorët e tregut. Sipas tij, ky veprim bie ndesh me dispozitat e nenit 14 par.14.1, 14.2 dhe 14.3 të Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, që sanksionohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-186 për plotësimin e Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, andaj mbështetur në këtë fakt është nxjerrë vendimi me nr. prot. 5744/19 i datës 09.08.2021, me të cili i është shqiptuar gjobë Paditësit në vlerë prej 1,000.00 euro.
6. I Paditurit gjithashtu ka deklaruar se, pretendimet e Paditësit se inspektorët e tregut nuk i kanë lënë kohë të mjaftueshme për të siguruar dokumentet e kërkuara nga të njëjtit si fatura e furnizimit me GLN, ndërsa bazuar në nenin 26 par.2 i Ligjit nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut ceket se afati i përcaktuar me procesverbal nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë ditë, ashtu që në rastin konkret të njëjtit i është dhënë afat maksimal për të prezantuar dokumentacionin e kërkuar. Për më tepër, sipas tij,

lidhur me pretendimin tjetër Padiësi kishte parashtruar kërkesë për licencim në Departamentin për Rregullimin e Tregut të Naftës në MINT, kjo kërkesë nuk nënkupton pajisje me licencë, për shkak se Inspektorati i Tregut nuk mund të paragjykoj se i njëjti i plotëson kushtet për tu pajisur me licencë ose i njëjti sigurisht se do të pajiset me licencë.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

7. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: aktvendimi ref.nr.19/21 i datës 09.08.2021 i Inspektoratit të Tregut, Vendimi nr.prot.6420 i datës 06.09.2021 i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, fletë dërgesa nr. 02/24/06/21 e datës 24.06.2021 e padiësit, dokument në gjuhën angleze me titull “Internal Transfer” e datës 24.06.2021, kërkesë për licencim për shitje me pakicë të GLN-së me nr. prot. 541 e datës 10.08.2021, licenca për biznes në sektorin e naftës me nr. 10049-00-17-075102 e datës 08.09.2021 e lëshuar nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe shkresat e lëndës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi.
8. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
9. I Padituri më 05.07.2021 e inspektuar filialin e Padiësit në rrugën “Gasper Karaqi” në Gjakovë dhe gjatë inspektimit përmes procesverbalit me nr.19/000519 kishte konstatuar Padiësi nuk posedon dokumentacionin e kërkuar nga inspektorët e tregut, gjegjësisht licencën për shitjen me pakicë të GLN-së dhe faturën e furnizimit me GLN. I Padituri përmes procesverbalit e ka urdhëruar Padiësit që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të prezantoj licencën për shitjen me pakicë të GLN-së dhe faturën e fundit të furnizimit me GLN. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit nr.19/000519 të datë 05.07.2021, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
10. I Padituri kishte konstatuar se Padiësi nuk i ka sjellë dokumentet e kërkuara edhe pas kalimit të afatit, rrjedhimisht përmes vendimit me nr. 5744 të datës 09.08.2021 i ka shqiptuar gjobën prej 1000€. I Padituri kishte arsyetuar se, mos dorëzimi i dokumenteve

është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit e nenit 14 par.14 .1 14.2 dhe 14.3 të Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut që sanksionohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-186 për plotësimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit të lartcekur.

11. Padiësi më 26.08.2021 kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të shkallës së parë, të cilën i Paditura si organ i shkallës së dytë përmes vendimit me nr. 6420 të datës 06.09.2021 të nxjerr nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut e ka refuzuar dhe e ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. I Padituri kishte arsyetuar se gjendja e konstatuar me procesverbalin me nr. 19/001559 të datës 05.07.2021 dhe shqiptimi i gjobës me aktvendimin e shkallës së parë janë në pajtim me dispozitat e nenit 14 par.14 .1 14.2 dhe 14.3 të Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut që sanksionohet me nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-186 për plotësimin e Ligjit Nr. 03/L -181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut.
12. Gjykata gjithashtu konstaton se Padiësi më 10.08.2024, pra pasi kishte kaluar afati prej 30 ditëve për dorëzimin e dokumenteve, kishte aplikuar për licencë për shitje me pakicë të GLN-së. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kërkesë për licencë me numër të protokollit 541 të datës 10.08.2021, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
13. Përveç kësaj, për këtë gjykatë nuk është vërtetuar se Padiësi i ka dorëzuar me kohë dokumentet e kërkuara, ose e ka pasur objektivisht të pamundshme (rrethana që nuk varen nga ai dhe janë të pashmangshme) që t'ia dorëzoj të Paditurit dokumentet e kërkuara, meqenëse Padiësi nuk ka paraqitura asnjë provë, nga e cila rrjedhin këto fakte.
14. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

15. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërëgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Padiësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht kërkesëpadia e Padiësit duhet të refuzohet

16. Në rend të parë gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Përveç kësaj, gjykata e gjen të pabazuar edhe pretendimin e Paditësi se vendimi i goditur ka të meta formale në pjesë e arsytimit, duke marrë parasysh faktin se vendimi i goditur përveç që i përmban të gjitha elementet e nevojshme të përcaktuar me nenin 47 të LPPA-së, si dhe arsytimi i vendimit të goditur i përmban të gjitha të dhënat nga neni 48 dhe 134 i LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
17. Gjithashtu, gjykata konstaton se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike lidhur me shkeljet e konstatuara. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se i Padituri kishte konstatuar se Paditësi nuk i kishte dorëzuar dokumentet e kërkuara, rrjedhimisht i kishte shqiptuar gjobë.
18. Fillimisht gjykata vëren se procesverbalin e inspektimit, në të cilin së pari janë bërë konstatimet për mungesën e faturës së fundit për furnizim me GLN dhe licencës për shitjen e GLN-së, Paditësi e kishte nënshkruar pa vërejtje. Në anën tjetër, Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë nga e cila do të provohet se brenda afatit prej 30 ditëve, siç ka kërkuar i Padituri, i ka dorëzuar këtij të fundit licencën për shitje me GLN dhe faturën e fundit të furnizimit me GLN, e as nuk ka paraqitur prova, nga të cilat do të rezultonte se objektivisht e ka pasur të pamundur që t'i dorëzojë ato dokumente. Gjykata rikujton se, sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon Paditësit për të vërtetuar se konstatimet e të Padituri nuk kanë qenë të sakta, përderisa në shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh diçka tjetër. Në anën tjetër, gjykata vë në pah se Paditësi pasi kishte kaluar afati për dorëzimin e licencës për shitjen e GLN-së kishte aplikuar për tu pajisur me atë licencë, pra nuk e ka pasur atë dokument gjatë inspektimit e as gjatë afatit shtesë. Për këto arsye, gjykata konstaton se gjendja faktike e vërtetuara nga i Padituri është e plotë dhe saktë.
19. Gjykata e sheh të arsyeshme se, se Paditësi nuk ka pasur asnjë pengesë objektive, konkretisht rrethana që nuk varen nga ai e as nuk ishin të evitueshme, për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, meqenëse për ushtrimin e rregullt të veprimtarisë së tij, ai është dashur që t'i ketë ato dokumente.

20. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 14 të Ligjit 03/L181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut (këtu e tutje LIMT), i cili në para. 2 ka përcaktuar se “*Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t’i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori*”, ndërsa në para. 3 të po të njëjtit nen ka përcaktuar se “*Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar*”. Sipas këtyre dispozitave, Inspektorati Tregut ka të drejtë që t’i lejoj një subjekti ekonomik që në afatin e caktuar nga ai t’ia dorëzoj dokumentet, në të cilat ka kërkuar që të ketë qasje, por që kanë munguar me rastin e inspektimit, ndërsa nëse subjekti ekonomik nuk vepron brenda afatit të caktuar nga Inspektorati i Tregut, atëherë konsiderohet se nuk i ka mundësuar qasje Inspektorati i Tregut.
21. Gjithashtu sipas nenit 33 para. 1 të LIMT-së (i ndryshuar) “*Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim: 1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik*”. Kjo nënkupton se, nëse personit juridik nuk i mundëson qasje Inspektoratit të Tregut sipas nenit 14 të LIMT-së, pra edhe pas mundësisë që dokumentin e kërkuar ta dorëzoj brenda afatit të caktuar, atëherë ai gjobitet në shumën e paraparë në atë paragraf.
22. Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ia ka dorëzuar me kohë Inspektoratit të Tregtisë dokumentin e kërkuar, atëherë ky i fundit me të drejtë i ka shqiptuar gjobë me aktin administrativ të shkallës së parë, ndërsa në shkallë të dytë me të drejtë është refuzuar ankesa e Paditësit.
23. Gjykata sqaron se meqenëse i Padituri e ka shqiptuar sanksionin më të butë të mundshëm, atëherë gjykata vlerëson se edhe trajtimi i proporcionalitetit të gjobës me shkeljen e konstatuar është i panevojshëm
24. Gjykata e gjen si të pabazuar pretendimin e Paditësit se, i Padituri nuk i ka dhënë kohë të mjaftueshme për t’i dorëzuar dokumentet e kërkuara. Sipas nenit 26 par.2 të Ligjit

Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, ku është paraparë se “*Afati i përcaktuar me procesverbal, nuk mund të jetë me i gjatë se tridhjetë (30) dite*”, që nënkupton se i Padituri i kishte dhënë Paditësit afatin maksimal ligjor për dorëzimin e dokumenteve.

25. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
26. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së, meqenëse Paditësi e kishte kërkuar shpërblimin e tyre përmes padisë.
27. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.689/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.